



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. _____ **Prot.** _____ **Tiranë** ____/____/2023
Nr. Dok.202200848/11

Lënda: *Rekomandim për fillimin e procedurave të verifikimit të konstatimeve të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit, në lidhje me ankesën e shtetas H.Ç., për të vlerësuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për prokurorin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, z. Xhelian Seferi*

KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Tiranë

INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Tiranë

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË

JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit në vitin 2022 është paraqitur ankesa e shtetas H.Ç. e cila parashton se vajza e saj ka mbetur invalide, si pasojë e mjekimit të

pakujdesshëm të mjekut Hekuran Kume. Sipas ankueses, ndaj mjekut është regjistruar procedimi penal nr.1039 i vitit 2014, për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”.

Në datën 30.07.2018 ajo ka marrë njoftim për përfundimin e hetimeve nga prokurori i çështjes dhe më pas, prej 4 vitesh, nuk ka dijeni dhe nuk është njoftuar se çfarë ka ndodhur me këtë procedim.

Për këtë arsye, ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të vajzës së saj (palë e dëmtuar).

Në këtë kuadër, i jemi drejtuar në mënyrë të përsëritur Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan lidhur me procedimin përkatës dhe hetimet e zhvilluara në mbështetje të nenit 63/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë *“Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”* si dhe në bazë të nenit 19 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Në shkresën nr.11503/1 prot., datë 21.10.2022 kjo prokurori referon si vijon:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, mbi bazën e kallëzimit të shtetasve R.Ç dhe A.Ç, më datë 28.04.2014 ka regjistruar procedimin penal nr.1039 të vitit 2014 për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm” të parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal, në dëm të shtetasës J.H.Ç.

Në datë 27.03.2014 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka regjistruar kallëzimin e shtetasve A. Ç dhe R.Ç. të cilët pretendojnë se motra e tyre J.Ç. (H) gjatë lindjes është mjekuar në mënyrë të pakujdesshme nga mjeku Hekuran Kume. Ata pretendojnë se veprimet e mjekut Hekuran Kume kanë shkaktuar gjendjen e vështirë të motrës së tyre e cila është me pasoja të shëndetit.

Nga ana e organit procedues është pyetur për të dhënë deklarime si person që tregon rrethana të hetimit shtetasi Hekuran Kume.

Është marrë vendim sekuestrimi në lidhje me sekuestrimin e kartelës së shtetases J. Ç (H) në spitalin e Gramshit.

Është sekuestruar kartela e konsultorit të ndjekjes së gruas shtatzënë me procesverbalin e datës 28.04.2014.

Në datë 09.05.2014 është marrë vendim për këqyrjen e regjistrit të vizitave gjinekologjike në spitalin e qytetit të Gramshit.

Në datë 09.05.2014 është marrë vendim për sekuestrimin e kartelës së shtetases J Ç (H) në spitalin “Xhaferr Kongoli” të qytetit të Elbasanit.

I është kërkuar informacion Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë Tiranë nëse ka ndonjë informacion për rastin në fjalë.

Në datë 22.05.2014 kallëzuesja R.Ç ka dorëzuar në sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan një material shtesë të kallëzimit ku kërkon që të merret në pyetje nga ekspertë mjekë.

Është pyetur si person që tregon rrethana të hetimit shtetasja R .Ç.

Në hetim është marrë vendim për këqyrjen e regjistrit të vizitave gjinekologjike në spitalin e qytetit të Gramshit.

Me qëllim marrjen e njohurive të posaçme në fushën e mjekësisë ligjore organi procedues ka vendosur kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është administruar akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr.1900, datë 31.10.2014, në konkluzionet e të cilit është përcaktuar kategoria e dëmtimit për të dëmtuarën J.H dhe fakti se në këtë rast janë konstatuar elemente të mjekimit të pakujdesshëm, në formën e veprimit apo mosveprimit, të kryera nga personeli i lartë mjekësor në spitalin e qytetit të Gramshit dhe Elbasanit.

Po kështu nga akti i ekspertimit rezulton se dëmtimet e shtetasës J.(Ç) H kanë ardhur si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të pakujdesshme të mjekimit të personelit mjekësor që është marrë me trajtimin mjekësor të saj gjatë ndjekjes së shtatzënisë, aktivitetit të lindjes dhe menjëherë pas lindjes.

Organi procedues ka vendosur kryerjen e një ekspertimi mjeko-ligjor për këtë çështje, duke kërkuar plotësimin e aktit të ekspertimit nr.1900, datë 31.10.2014 të ekspertëve të IML-së Tiranë.

Është administruar akti i ekspertimit mjeko-ligjor plotësues nr.433, datë 06.03.2015.

Në hetim u janë marrë deklarime shtetasve M.D, Z .S, Xh.M, N.D, J.H.(Ç), E.H, J.J., A. L., Z.T, A.P, R..Ç, E.Sh (mjek-ligjor), Z.I (mjek-ligjor), të cilët kanë shpjeguar rreth ngjarjes.

Po sipas përgjigjes së prokurorisë me shkresën nr.11503/1 prot., datë 21.10.2022, gjatë seancës gjyqësore, (nuk referohet datë) nga prokurori është kërkuar kthimi i çështjes për hetime të mëtejshme dhe kërkesa është pranuar nga gjykata.

Në rihetim janë marrë deklarime të shtetasit F.S, ekspert mjeko-ligjor.

Sa më sipër, për këtë procedim penal janë marrë të pandehur shtetasit (mjekët) Hekuran Kume, Armida Tola, Teuta Kadaifçi dhe Besnik Tollumi të akuzuar për veprën penale të “Mjekimi i pakujdesshëm” parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal.

Hetimet paraprake janë përfunduar dhe çështja është në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Në vijim të hetimit tonë administrativ, me shkresën nr.K2/H7-5 prot., datë 03.11.2022 i jemi drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan e cila me shkresën nr.1701/1 prot., datë 30.11.2022 sqaron se nga verifikimi i sistemit elektronik të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Elbasan nuk rezulton çështje penale e regjistruar (vitet 2018-2022) me të pandehur mjekët Hekuran Kume, Armida Tola, Teuta Kadaçiu dhe Besnik Tollumi të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.

Avokati i Popullit konstatoi se hetimet e kësaj çështjeje janë zgjatur në tejkalim të afateve të përshtatshme¹ për një proces të rregullt ligjor, pavarësisht se për periudhën 2014-2017 çështja ka qenë në hetim nga prokuror tjetër, i cili më pas ka dhënë dorëheqjen.

Ndërkohë, në datë 28.06.2017 gjykata ka marrë vendim për kthimin e akteve të procedimit penal nr.1039 të vitit 2014 dhe vazhdimin e hetimeve. Prej kësaj date e në vijim hetimet janë ndjekur nga prokurori Seferi.

Nga organi i prokurorisë na është dhënë përgjigje që çështja është në gjykim nga gjykata, fakt i cili bie në kundërshtim me përgjigjen e dërguar nga vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan nëpërmjet shkresës nr.1701/1 prot., datë 30.11.2022.

Gjithashtu, pala e dëmtuar **prej vitit 2018** nuk kishte asnjë njoftim se çfarë ishte bërë me çështjen dhe hetimet.

Për këtë arsye, nga ana jonë u vendos të kryhej verifikimi në vend i rastit objekt ankese, duke shkuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Pas takimit të zhvilluar me drejtuesin e Prokurorisë, z.Kreshnik Ajazi, si dhe më pas me prokurorin e çështjes z. Xhelian Seferi, na u bënë prezent problematikat me të cilat përballeshin lidhur me vakancat, si dhe numrin e lartë të dosjeve të grumbulluara.

¹ Në nenin 323 “Afatit i hetimeve paraprake” të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet si vijon:

1. Brenda përfundimit të afatit ligjor të hetimeve, prokurori vendos sipas paragrafit 6, të nenit 327, të këtij Kodi. 2. Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi.

Avokati i Popullit vlerëson se funksionimi i sistemit të drejtësisë dhe organit të akuzës prej disa viteve po përballet me vështirësi dhe sfida të mëdha. Vijimi i reformës në drejtësi, ka rritur volumin e punës në sistem, për shkak të mungesave dhe largimeve të një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh e prokurorësh dhe moszëvendësimit të tyre me të rinj.

Miratimi i reformës në drejtësi dhe zbatimi i saj kishin si qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, por për shkak të hapave tepër të ngadaltë me të cilët ajo po ecën, ka cenuar të drejtën për akses në drejtësi dhe drejtësinë pa vonesa. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka theksuar nëpërmjet rekomandimeve dhe mendimit të tij të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese se vënia në zbatim e hartës së re gjyqësore do të implikojë më tej aksesin në drejtësi të qytetarëve².

Por në këtë rast, duke sjellë në vëmendje që regjistrimi i procedimit penal daton që nga viti 2014, konstatojmë qartazi se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Kështu, nga shqyrtimi në vend i dosjes penale lidhur me procedimin penal nr.1039 të vitit 2014 të regjistruar ndaj mjekut Hekuran Kume, për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, ka rezultuar se në datë 28.06.2017 kjo dosje është kthyer nga gjykata, me qëllim vazhdimin e hetimeve të mëtejshme.

Në vijim, nga prokuroria janë kryer disa veprime hetimore si: ekspertime, pyetje të personave që kanë dijeni për veprën penale, marrja si të pandehur e shtetasve të tjerë. Po ashtu, për këtë procedim penal janë marrë të pandehur mjekët Hekuran Kume, Armida Tola, Teuta Kadaifçiu dhe Besnik Tollumi, të akuzuar për veprën penale “Mjekimi i pakujdesshëm” parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.

² Për më tepër shih rekomandimin:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20botim.pdf>

Duhet theksuar se hetimet e mësipërme janë tejzgjatur në kohë dhe pa afat, **prej datës 28.06.2017 e deri në vitin 2023 (gati 6 vjet)**. Pra, dosja vijonte të qëndronte në prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe nuk ishte dërguar në gjykatë siç ishim informuar në mënyrë të papërgjegjshme dhe aspak korrekte nga kjo prokurori.

Me qëllim moszvarritjen më tej të gjykimit të kësaj çështjeje, i kemi kërkuar me shkrim prokurorisë dërgimin sa më parë në gjykatë të dosjes, si dhe njoftimin pa vonesë të palës së dëmtuar në zbatim të garancive procedurale penale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Kemi ritheksuar se edhe për vetë ndjeshmërinë e lartë të çështjes, çdo vonesë në kryerjen e këtyre veprimeve procedurale është në dëm të procesit të rregullt ligjor dhe cenon rëndë besimin e publikut te organi i prokurorisë.

Më tej, me shkresën nr.10375/1 prot., datë 27.10.2023 Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan referon si vijon:

“Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbi bazën e kallëzimit të shtetasve R.Ç dhe A.Ç më datë 28.04.2014 ka regjistruar procedimin penal nr.1039 të vitit 2014 për veprën penale të “Mjekim i pakujdesshëm” të parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal në dëm të shtetas J. H. (Ç).

Për këtë procedim penal janë marrë të pandehur shtetasit (mjekët) Hekuran Kume, Armida Tola, Teuta Kadaifçiu dhe Besnik Tollumi të akuzuar për veprën penale të “Mjekimi i pakujdesshëm” parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal.

Hetmet paraprake janë përfunduar dhe çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.”

Bashkëlidhur janë vënë në dispozicion kopje e kartelës për gjykim, shkresës së dërgimit të akteve në gjykatë, si dhe të njoftimit të kërkesës viktimës.

Në sajë të ndërhyrjes sonë, u bë i mundur dërgimi në gjykatë i çështjes, por kjo nuk anashkalon faktin se hetimet për këtë çështje janë tejzgatur me vite të tëra dhe në shkelje të afateve ligjore, konkretisht prej vitit 2014 dhe deri në vitin 2023 (gati 9 vjet).

Akresi në drejtësi dhe zbatimi me rigorozitet i parimeve bazë të një procesi të rregullt ligjor, duhet të udhëheqin punën dhe veprimtarinë e organit të prokurorisë.

Po ashtu, çmojmë se prokurorët duhen të marrin masat e nevojshme dhe efektive për të evituar zvarritje të mëtejshme dhe të pajustificuara në ndjekjen dhe kryerjen e veprimeve hetimore, çka në rast të kundërt do të përbënte cenim të një procesi të rregullt ligjor.

Veprimet dhe zvarritjet e pajustificuara bien ndesh me nenin 42 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë në të cilin përcaktohet: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.*

Që prej datës 30.07.2018 pala e dëmtuar sqaron se ka marrë njoftim për përfundimin e hetimeve nga prokurori dhe më pas, prej më shumë se 4 vitesh, nuk kanë dijeni çfarë ka ndodhur me këtë çështje.

Në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale parashikohen të drejtat e viktimës akuzuese:

“1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119,119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

2. *Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.*
3. *Nëse viktima akuzuese ose mbrojtësi i caktuar prej tij nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimin.*
4. *Viktima akuzuese që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor.*
5. *Kur disa viktima të së njëjtës çështje paraqesin kërkesë në gjykatë, sipas nenit 59, të këtij Kodi, kërkesat e tyre bashkohen në një gjykim të vetëm.”*

Për sa parashtruar, në rastin objekt hetimi është detyrim i organit të akuzës që në përfundim të hetimeve, të njoftojë viktimën akuzuese.

Gjatë hetimit administrativ, po ashtu është konstatuar se fillimisht nuk ka pasur një bashkëpunim të mirë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me Avokatin e Popullit, në kuadër të kthimit të përgjigjeve, përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Vlerësojmë të drejtë ankesën e shtetases H.Ç dhe për këtë do të rekomandonim vlerësimin e shqetësimeve të paraqitura nga ana e saj, me qëllim për të vënë në vend të drejtën e shkelur, duke respektuar kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Ankuesja ka ngritur shqetësimin e mungesës totale të informacionit prej vitit 2018 dhe mungesës së vënies në vend të drejtësisë.

Prej vitit 2017 e deri në tetor 2023 çështja nuk ishte ridërguar në gjykatë, jashtë çdo afati të arsyeshëm. Vetëm pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

E drejta për një proces të rregullt ligjor parashikohet në nenin 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Garancitë e parashikuara në nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe

në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Duke qenë një e drejtë kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt ligjor e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, si në respektimin e të drejtave procedurale, ashtu dhe në zhvillimin e hetimit e gjykimit brenda një “afati të arsyeshëm”, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare prej tij. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, si dhe detyrimin për realizimin e një hetimi e gjykimi objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër.

Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e kushtetutës e të ligjeve të shtetit.

Institucioni i Avokatit të Popullit vendos theksin tek rëndësia që ka transparenca dhe e drejta e palëve për informim si element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Rritja e besimit që qytetarët duhet të kenë tek sistemi i drejtësisë mund të realizohet vetëm me ndryshimin e qasjes së organit të prokurorisë sa i takon informimit dhe njoftimit të qytetarëve.

Për sa trajtuam më lart, çojmë se nga strukturat kompetente të cilat vlerësojnë performancën e punës së magjistratëve duhet të analizohen shkeljet ligjore të kryera në këtë rast nga prokurori i çështjes z. Xhelian Seferi, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe të mbahet qëndrim ligjor ndaj tij mbi veprimet/mosveprimet përkatëse.

Pas këtij rasti dhe në përgjithësim të problematikës së evidentuar më lart, vlerësojmë se duhet të ketë sisteme të cilat të evidentojnë dosjet pa veprime procedurale, apo me afate të tejkgjatura në mënyrë që të evitohet përsëritja e këtyre rasteve. Qëllimi i reformës në drejtësi ishte ai i kthimit të besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Për këtë, gjatë reformës u morën vendime me kosto shumë të mëdha si në nivel njerëzor, ashtu edhe në

aspektin financiar. Për këtë arsye, duhet të jemi në mënyrë të veçantë të kujdesshëm për të mos lejuar veprime apo fenomene të cilat do të mund të ulin përsëri besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend* dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ankuesit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, në ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 21/b, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, dhe në nenin 21/c, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen,*

REKOMANDOJMË:

- Fillimin e procedurave të verifikimit të konstatimeve të bëra nga institucioni ynë, në kuadër të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”* i ndryshuar, në lidhje me ankesën e shtetases H.Ç. për të vlerësuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për prokurorin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Xhelian Seferi.
- Vlerësimin e zbatimit të sistemeve apo procedurave që të garantojnë kontrollin dhe verifikimin periodik të afateve të hetimit të dosjeve për të mos lejuar përsëritjen e të tilla rasteve në të ardhmen.

- Marrjen e masave për sigurimin e një bashkëpunimi më të mirë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me institucionin e Avokatit të Popullit, duke rritur transparencën, shmangur burokracitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e informacionit të saktë dhe dokumenteve hetimore.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 04. 02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA